

Ceremonia e 8P – E premte, 1 korrik 2022 – Victoria Hall

INFORMACIONE PËR FAMILJEN/PRINDËRIT

Nga ora 15:30 deri në 16:30 – Ceremonia zyrtare

Nga ora 15:30 deri në orën 16:30, Victoria Hall pret nxënësit e klasës së 8P dhe mësuesin/-en e tyre për një ceremoni të dedikuar nxënësve që përfundojnë shkollimin e tyre fillor (*fletushkë për t'u shkarkuar në fund të faqes*).

Është një etapë e rëndësishme në jetën e nxënësve: largimi nga bota e fëmijërisë dhe hyrja në atë të adoleshencës, me sfidat e veta të shumta.

Për të shënuar këtë kalim, Qyteti i Gjenevës organizon posaçërisht një eveniment zyrtar të rezervuar për nxënësit dhe mësuesin/-en e tyre.

Ceremonia e zhvilluar gjatë orarit shkollor nuk është e hapur për prindërit.

Nga ora 16:30 deri në orën 17:00 – Pritje në parkun e Bastions

Pas përfundimit të ceremonisë, nxënësit rigrupohen sipas klasave për të shkuar deri në parkun e Bastions, të shoqëruar prej mësuesit/-eses/-ve, agjentëve të policisë bashkiake, patrullave shkollore dhe personelit të Shërbimit të Shkollave.

Ata mund të përfitojnë që tani prej argëtimit të organizuara për festën e klasave 5P-8P përpara hapjes.

Prej orës 17:00 – Hapje e festimeve në parkun e Bastions

Prindërit duhet të takohen me fëmijën/-ët e tyre në vend. Për lehtësimin e pikave të takimit, tabelat me emrat e shkollave fillore vendosen pranë tavolinave. Nxënësit nuk janë më në përgjegjësinë e mësuesit/-eses/-sve të tyre.

Hyrja në Parkun e Bastions

Tramvajet 12 dhe 18

Autobusët 3, 5, 36

Stacioni: Place de neuve

Informacion

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijë

022.418.48.38

ecoles@ville-ge.ch